<b>Shpejt 30 min (A)</b>	30°C	❄️ - 30°C	1200 (4)	4,5	0:30	●	●	-	●	○	-	✓	71	0,178	37	27
<b>Rrotullim dhe Shkarkim *</b>	-	-	1400	9,0	**	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Shpëlarje dhe rrotullim</b>	-	-	1400	9,0	**	-	-	-	-	○	-	-	-	-	-	-
<b>Freskim me avull</b>	-	-	-	2,0	**	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>20°C</b>	20°C	❄️ - 20°C	1400	9,0	1:50	-	●	-	●	○	-	✓	55	0,138	78	22
<b>Të lehta</b>	40°C	❄️ - 40°C	800	2,0	**	-	●	-	●	○	-	✓	-	-	-	-
<b>Kundër alergjisë</b>	60°C	40°C-60°C	1400	5,0	**	-	●	-	●	○	✓	✓	-	-	-	-
<b>Çarçafë dhe peshqirë (A)</b>	60°C	❄️ - 60°C	1400	9,0	**	●	●	-	●	○	✓	✓	-	-	-	-

● Doza e kërkuar ○ Doza opsionale


Këto të dhëna mund të ndryshojnë në shtëpinë tuaj, për shkak të ndryshimit të cilësive të ujit, p.sh. temperaturës, presionit etj. Vlerat e përafërta të kohëzgjatjes së programeve vlejnë për cilësimet e parazgjedhura të programeve, pa opsionet. Vlerat e dhëna për programet, përveç programit Eko. 40-60, janë vetëm treguese.  
**1) Eko. 40-60** - Cikël larjeje provë në përputhje me Rregulloren 2019/2014 të BE-së "Për dizajnin ekologjik". Programi më efikas për sa i përket konsumit të energjisë dhe ujit për larjen e veshjeve të pambukut me ndotje normale.  
**Shënim:** vlerat e shpejtësisë së rrotullimit, që shfaqen në ekran, mund të ndryshojnë pak nga vlerat që jepen në tabelë.

**Për të gjitha institutet e testimit:**  
 2) Cikël i gjatë për të pambukta: caktoni ciklin e larjes Të pambukta në temperaturën 40°C.  
 3) Cikël i gjatë për sintetiket: caktoni ciklin e larjes Sintetike në temperaturën 40°C.

4) Në ekran do të shfaqet shpejtësia e sugjeruar e rrotullimit si vlerë e parazgjedhur.  
 \* Duke zgjedhur ciklin **Rrotullim dhe Shkarkim** dhe duke përfunduar ciklin e rrotullimeve, lavatriçja vetëm do të shkarkohet.  
 \*\* Kohëzgjatjen e cikleve të larjes mund ta shihni në ekran.  
 \*\*\* Për paralarjen shtypni butonin "**Temp.**" derisa simboli të ndriçojë (vetëm 90°).  
 \*\*\*\* Pas përfundimit të programit dhe ciklit të rrotullimeve me shpejtësinë maksimale të zgjedhshme të rrotullimeve, në cilësimin e parazgjedhur të programit.

**PËRSHKRIMI I PRODUKTIT**

- Lart
- Sirtari i ndarjes së detergjentit
- Paneli i kontrollit
- Doreza
- Dera e lavatriçes
- Pompa e shkarkimit (pas kapakut të poshtëm)
- Kapaku i poshtëm (i heqshëm)
- Këmbët e rregullueshme (2)




**SIRTARI I NDARJES SË DETERGJENTIT**

**ndarja 1: Detergjent për paralarjen (pluhur)**  
**ndarja 2: Detergjent për ciklin e larjes (pluhur ose i lëngshëm)**

Nëse përdoret detergjent i lëngshëm, rekomandohet që për dozën e duhur të përdoret ndarja plastike A (e ofruar), e cila është e heqshme.

Nëse përdoret detergjent pluhur, vendoseni ndarjen te foleja B.

**ndarja 3: Aditivët (zbutësit e rrobave etj.)**  
 Zbutësi i rrobave nuk duhet ta tejkalojë kufirin e rretës.



⚠️ Përdorni detergjent pluhur për veshjet e bardha prej pambuku, për paralarje dhe për larje në temperatura mbi 60°C.  
 ⚠️ Ndiqni udhëzimet që jepen në paketimin e detergjentit.



## CIKLET E LARJES

Ndihni udhëzimet në simbolet e etiketës së veshjes për kujdesin gjatë larjes. Vlera e treguar në simbol është temperatura maksimale e rekomanduar për larjen e veshjes.



### Eko. 40-60

Për larjen e veshjeve të pambukta me ndotje normale, në etiketën e të cilave tregohet se mund të lahen në 40°C ose 60°C së bashku në të njëjtin cikël. Ky është programi standard për të pambukatat dhe më efikas për sa i përket konsumit të ujit dhe energjisë.

### Të pambukta

Për rrobat e pambukta rezistente, që janë mesatarisht të ndotura ose shumë të ndotura.

### Sintetike

I përshatshëm për larjen e veshjeve me ndotje të moderuar, të përbëra nga fibrat sintetike (p.sh. fibra poliestere, poliakrilike, viskoze etj.) ose fibra të përziera sintetike-pambuku.

### Të përziera

Për larjen e veshjeve të forta, me ndotje të lehtë dhe normale, të bëra nga pambuku, lini, fibrat sintetike dhe fibrat e përziera.

### Delikate

Për larjen e veshjeve shumë delikate. Këshillohet t'i përvishni nga ana tjetër rrobat përpara se t'i lani. Për të arritur rezultatet më të mira, përdorni detergjent të lëngshëm për rrobat delikate.

### Të bardha

Për larjen e peshqirëve, të brendshmeve, mbulesave të tavolinës dhe të krevatit etj., që janë të forta, prej pambuku dhe lini dhe që janë mesatarisht të ndotura ose shumë të ndotura. Vetëm kur temperatura e zgjedhur e ciklit është 90°C, cikli nis në fillim me fazën e paralarjes, pastaj të larjes kryesore. Në këtë rast, rekomandohet të shtoni detergjent në të dyja dhomëzat: edhe tek ajo e paralarjes, edhe tek ajo e larjes kryesore.

### Kundër njollave 40°

Programi është i përshatshëm për larjen e rrobave shumë të ndotura dhe me ngjyra rezistente. Ky program garanton larje të një klasi më të lartë sesa larja e klasit standard (klasi "A"). Kur përdorni këtë program, mos përzieni rroba me ngjyra të ndryshme. Rekomandojmë të përdorni detergjent pluhur. Trajtimi paraprak me aditivë të posaçëm rekomandohet kur ka njolla të vështira për t'u hequr.

### Shpejt 30 min

Për larjen e shpejtë të rrobave pak të ndotura. Ky cikël zgjat vetëm 30 minuta dhe ju kursen edhe kohë, edhe energji elektrike.

### Rrotullim dhe shkarkim

Rrotullon ngarkesën dhe pastaj zbraz ujin. Për veshjet rezistente. Nëse nuk e aktivizoni ciklin e rrotullimit, pajisja do të bëjë vetëm shkarkimin e ujit.

### Shpëlarje dhe rrotullim

Shpëlan ngarkesën dhe pastaj rrotullohet. Për veshjet rezistente.

### Freskim me avull

Veshjet do të jenë të lagura kur cikli të ketë përfunduar, ndaj ne rekomandojmë t'i ndeni ato për t'i tharë (2 kg, afërsisht 3 artikuj). Ky program i freskon rrobat duke hequr aromat e këqija dhe duke i shtendosur fibrat. Fusni vetëm artikuj të thatë (që nuk janë të papastër) dhe zgjidhni programin "Freskim me avull". Në fund të ciklit, rrobat do të kenë njëfarë lagështie, por mund t'i vishni pas disa minutash. Programi "Freskim me avull" e bën hekuriosjen më të lehtë.

! Mos shtoni zbutës ose detergjente.

! Nuk rekomandohet për veshje të leshta dhe të mëndafshta.

### 20°C

Për larjen e veshjeve të pambukta pak të ndotura në një temperaturë prej 20°C.

**Të leshta - Wool Care:** Cikli i larjes së veshjeve të leshta me këtë lavatriçe është miratuar nga kompania "The Woolmark Company" për larjen e produkteve të leshit, që mund të lahen me lavatriçe, me kusht që produktet të lahen duke respektuar udhëzimet që jepen në etiketën e veshjeve dhe udhëzimet që jepen nga prodhuesi i kësaj lavatriçeje. Simboli i kompanisë "Woolmark" është shenjë certifikimi në shumë shtete. M2225.



### Kundër alergjisë


I përshatshëm për të hequr substancat kryesore që shkaktojnë alergji, si poleni, këpshat e vogla dhe gimet e maceve ose të qenve.

### Çarçafë dhe peshqirë

Për larjen e mbulesave shtëpiake në një cikël të vetëm. Optimizon përdorimin e zbutësit të rrobave dhe kursen kohë dhe elektricitet. Rekomandojmë të përdorni detergjent pluhur.

## EKRANI

Ekrani ju ndihmon kur bëni programimin e lavatriçes dhe ju ofron informacione të shumta.



Kohëzgjatja e cikleve të mbetura të larjes dhe koha e mbetur e ciklit që po kryhet shfaqen në seksionin **A** (në ekran shfaqet kohëzgjatja maksimale e ciklit të zgjedhur, e cila mund të ulet pas disa minutash, duke qenë se kohëzgjatja reale e programit ndryshon në varësi të ngarkesës së larjes dhe cilësimeve të zgjedhura). Nëse keni zgjedhur opsionin "NISJE MË VONESË", në ekran do të shfaqet numërimi mbrapsht deri në fillimin e ciklit të zgjedhur të larjes.

Nëse shtypni butonin përkatës, mund të shihni shpejtësinë maksimale të rrotullimeve dhe temperaturën, të cilat maten nga lavatriçja gjatë ciklit të përcaktuar të larjes ose janë të njëjta me vlerat e përzgjedhura më së fundmi në rast se këto janë të përshatshme për ciklin e përcaktuar të larjes. "Fazat e ciklit të larjes" që korrespondojnë me ciklin e zgjedhur të larjes dhe me "fazën e ciklit të larjes" së ciklit që po kryhet, shfaqen në seksionin **B**:

Larja kryesore

Shpëlarja

Rrotullimi + Nxjerrja

Referencat te **C** tregojnë opsionet e disponueshme të larjes (Shihni seksionin "Opsionet").

Kur ndizet simboli "Nisje me vonesë" (h), nënkupton se në ekran është shfaqur vlera e caktuar e "nisjes me vonesë".

Simboli tregon mundësinë e futjes së një veshjeje shtesë në programin e nisur të larjes (Shihni seksionin "Shtimi i veshjeve").

Simboli tregon mundësinë për të heshtur tingujt e butonave Kur heshtja është aktive, pothuajse të gjithë tingujt do të fiken. Vetëm sinjalet zanore dhe alarmet mbeten aktive, si edhe tingulli në përfundim të ciklit. Për aktivizimin/çaktivizimin e heshtjes shtypni dhe mbani shtypur butonin .

### TREGUESIT E EKRANIT

Defekt: Telefonojni shërbimit

Shihni seksionin "Zgjidhja e problemeve"

Defekt: Filtri i ujit është bllokuar

Uji nuk shkarkohet. Filtri i ujit mund të jetë bllokuar

Defekt: Nuk ka ujë

Nuk vjen ujë fare ose sasia që vjen është e pamjaftueshme.

Nëse ndodh ndonjë defekt, shihni seksionin "Zgjidhja e problemeve".

### Kyçja e butonave

Për të kyçur panelin e kontrollit, shtypni dhe mbani shtypur butonin "Kyçja e butonave" për rreth 3 sekonda. Në ekran ndizet simboli për të treguar që paneli i kontrollit është kyçur (me përjashtim të butonit "NDEZJA/FIKJA" ). Në këtë mënyrë, parandalohen ndryshimet e paqëllimshme të programeve, sidomos kur fëmijët ndodhen pranë pajisjes. Për të shkyçur panelin e kontrollit, shtypni dhe mbani shtypur butonin "Kyçja e butonave" për rreth 3 sekonda.

### Treguesi i kyçjes së derës

Kur ndizet, simboli tregon se dera është e kyçur. Për të parandaluar dëmtimet, prisni derisa simboli të fiket para se të hapni derën. Për të hapur derën ndërkohë që cikli është në kryerje e sipër, shtypni butonin "NISJA/VENDOSJA NË PAUZË" . Kur fiket simboli , kjo nënkupton se dera mund të hapet.

## PËRDORIMI PËR HERË TË PARË

Pasi pajisja të jetë instaluar dhe para se ta përdorni për herë të parë, ekzekutoni një cikël larjeje me detergjent dhe pa rroba, duke caktuar ciklin me **Të bardha** **A** (60°).

## PËRDORIM I PËRDITSHËM

Përgatitsni rrobat për larje duke ndjekur sugjerimet e dhëna në seksionin "KËSHILLA DHE SUGJERIME".

- Shtypni butonin "NDEZJA/FIKJA" .

- Hapni derën. Fusni rrobat duke u siguruar që të mos tejkaloni sasinë maksimale të ngarkesës që jepet në tabelën e cikleve të larjes.

- Tërhiqeni sirtarin e ndarjes së detergjentit dhe hidhni detergjentit në ndarjet përkatëse siç përshkruhet në seksionin "SIRTARI I NDARJES SË DETERGJENTIT".

- Mbyllni derën.

- Lavatriçja shfaq automatikisht vlerat e paracaktuara të temperaturës dhe të shpejtësisë së rrotullimeve për ciklin e zgjedhur, ose cilësimet më të fundit nëse këto përshatën me ciklin e zgjedhur.

- Zgjidhni ciklin e dëshiruar të larjes.

- Zgjidhni opsionet që dëshironi.

### NISJA E CIKELIT

Shtypni "NISJA/VENDOSJA NË PAUZË" .

Lavatriçja do të kyçë derën (simboli ndizet) dhe kazani do të nisë të rrotullohet. Dera do të shkyçet (simboli fiket) dhe më pas do të kyçet sërish (simboli ndizet) në kuadër të fazës përgatitore të çdo cikli larjeje. Zhurma kërcitëse është pjesë e mekanizmit të mbylljes së derës. Uji do të hyjë në kazan dhe do të nisë faza e larjes pasi dera të jetë kyçur.



### VENDOSJA NË PAUZË E CIKELIT

Për të vendosur në pauzë ciklin e larjes, shtypni përsëri butonin "NISJA/VENDOSJA NË PAUZË" . Për të nisur ciklin e larjes që nga pika ku është ndërprerë, shtypni përsëri butonin "NISJA/VENDOSJA NË PAUZË" .




### HAPJA E DERËS, NËSE ËSHTË E NEVOJSHME

Pas nisjes së një cikli, simboli ndizet për të sinjalizuar që dera nuk mund të hapet. Dera mbetet e kyçur gjatë kohës që është duke u ekzekutuar një cikël larjeje. Për të hapur derën kur cikli është duke u kryer, për shembull, për të shtuar ose hequr veshje, shtypni butonin "NISJA/VENDOSJA NË PAUZË" për ta vendosur ciklin në pauzë. Nëse nuk ndizet simboli , do të thotë që dera mund të hapet. Shtypni përsëri butonin "NISJA/VENDOSJA NË PAUZË" për të vazhduar ciklin.



## SHTIMI I VESHJEVE

Një ikonë në ekran do të sinjalizojë kur mund të futen veshje shtesë në lavatriçe, pa ulur performancën e larjes. Për të shtuar veshje, së pari ndaloni punën e lavatriçes duke shtypur butonin "NISJA/VENDOSJA NË PAUZË" , më pas hapni derën dhe futni veshjet. Shtypni përsëri butonin "NISJA/VENDOSJA NË PAUZË"  për të rinisur ciklin e larjes nga momenti kur u ndërpre.

## NDRYSHIMI I NJË CIKLI LARJEJE QË ËSHTË DUKE U EKZEKUTUAR

Për të ndryshuar një cikël larjeje ndërsa ai është duke u ekzekutuar, vendoseni në pauzë punën e lavatriçes duke shtypur butonin "NISJA/VENDOSJA NË PAUZË" , më pas zgjidhni ciklin që dëshironi dhe shtypni përsëri butonin "NISJA/VENDOSJA NË PAUZË" . Për të anuluar një cikël që ka filluar tashmë, shtypni dhe mbani shtypur butonin "NDEZJA/FIKJA" . Cikli do të ndalohet dhe lavatriça do të fiket.

## NË FUND TË CIKLIT TË LARJES

Fundi i ciklit të larjes sinjalizohet nëpërmjet shfaqjes së fjalës "END" në ekran. Kur fiket simboli , do të thotë që dera mund të hapet. Hapni derën, hiqni rrobat dhe fiken lavatriçen. Nëse nuk shtypni butonin "NDEZJA/FIKJA" , lavatriça fiket automatikisht pas rreth 10 minutash.

## OPSIONET

- Nëse opsioni i zgjedhur nuk përputhet me ciklin e caktuar të larjes, drita treguese do të pulsojë dhe do të krijojë një dridhje, dhe opsioni nuk do të aktivizohet.
- Nëse opsioni i zgjedhur nuk përputhet me një cikël të mëparshëm të larjes, drita treguese do të pulsojë dhe do të krijojë një dridhje, dhe opsioni nuk do të aktivizohet.

### Higjiena me avull

Ky opsion përmirëson larjen nëpërmjet krijimit të avullit gjatë ciklit të larjes, me qëllim heqjen e baktereve nga fibrat, të cilat trajtohen në të njëjtën kohë. Vendosni rrobat në kazan, zgjidhni një program të përshatshëm dhe zgjidhni opsionin "Higjiena me avull". Avulli që krijohet gjatë punës së lavatriçes mund të bëjë që xhami i derës së lavatriçes të mjegullohet.

### Shpejt / Ekologjike

Pasi ta shtypni butonin për herë të parë, do të zgjidhet opsioni "Shpejt" dhe kohëzgjatja e ciklit do të pakësohet. Përndryshe, pas herës së 2-të, zgjidhet opsioni "Ekologjike" për të kursyer më shumë energji.


### Kujdesi përfundimtar

Lavatriça do të kryejë rrotullime të ngadalta të kazanit. Opsioni "Kujdesi përfundimtar" nis pas mbarimit të ciklit për jo më shumë se 6 orë. Ju mund ta ndërpriti në çdo kohë duke shtypur cilindo buton në panelin e kontrollit ose duke rrotulluar çelësin rrotullues.

### Kujdesi aktiv

Detergjenti, i përzier paraprakisht me ujë, krijon një përzierje unike që mund të futet më mirë në fibrat e veshjeve, pastron njoilat edhe në temperatura të ulëta, duke ruajtur si ngjyrat edhe përbërjen e copës. Këto rezultate përfitohen edhe për shkak të lëvizjeve të veçanta dhe të ndryshme të kazanit, të cilat shërbejnë për përkujdesjen më të mirë të veshjeve. Për këtë opsion, rekomandohen detergjentet në trajtë pluhuri dhe lëngu.

### Nisja me vonesë

Për të caktuar një nisje me vonesë për ciklin e zgjedhur, shtypni butonin përkatës në mënyrë të vazhdueshme derisa të arrihet periudha e dëshiruar e vonesës. Kur aktivizohet ky opsion, në ekran ndizet simboli . Për të çaktivizuar opsionin e nisjes me vonesë, shtypni butonin derisa në ekran të shfaqet fjala "OFF".


### Temperatura

Çdo cikël larjeje ka një temperaturë të paracaktuar. Për të ndryshuar temperaturën, shtypni butonin "Temp". Vlera do të shfaqet në ekran.

### Rrotullimet

Çdo cikël larjeje ka një shpejtësi të paracaktuar rrotullimesh. Për të ndryshuar shpejtësinë e rrotullimeve, shtypni butonin "Centrifuga". Vlera do të shfaqet në ekran.

## PROCEDURA E PASTRIMIT

Një ikonë  në ekran do t'i kujtojë përdoruesve rregullisht (thua se çdo 50 cikle) se është koha për të kryer një cikël mirëmbajtjeje, për të pastruar lavatriçen dhe për të hequr shtresat gëlqerore të krijuara dhe aromat e pakëndshme. Për të fshirë lajmërimin për pastrimin, rrotulloni çelësin ose shtypni një buton të çfarëdoshëm (përfshirë butonin "NDEZJA/FIKJA"). Për mirëmbajtje optimale, ne sugjerojmë të përdorni pastrues gëlqereje dhe yndyrë "WPRO", sipas udhëzimeve të treguara në paketim. Produkti mund të blihet duke kontaktuar shërbimin e ndihmës teknike ose nëpërmjet faqes së internetit [www.whirlpool.eu](http://www.whirlpool.eu).

Whirlpool nuk mban përgjegjësi për ndonjë dëmim të pajisjes të shkaktuar nga përdorimi i produkteve të tjera të pastrimit për lavatriçe, që ofrohen në treg.

## KËSHILLA DHE SUGJERIME

### Ndajini rrobat sipas

Llojit të rrobës/etiketës së larjes (pambuk, fibra të përziera, sintetike, të leshta, rroba që duhen larë me dorë). Ngjyrës (ndajini artikujt me ngjyra nga ata të bardhë, lajini veçmas artikujt e rinj me ngjyra). Delikatëve (lajini artikujt e vegjël si çorapet prej najloni dhe artikujt me grepa si reçipetat,

duke i futur në një çantë rrobe ose këllëf jastëku me zinxhir).

### Zbrazini të gjithë xhepat

Sendet si monedhat ose çakmakët mund të dëmtojnë edhe rrobat, edhe kazanin e lavatriçes.

### Ndiqni rekomandimet për dozat/aditivët

Kështu do të optimizohet rezultati i pastrimit, do të shmangen mbetjet acaruese të detergjentit të tepërt në rrobat tuaja dhe do të kurseni para duke shmangur shpërdorimin e detergjentit të tepërt

### Lani në temperaturë të ulët dhe për një kohë më të gjatë

Programet me temperatura më të ulëta dhe me kohëzgjatje më të madhe zakonisht janë më efikase për sa i përket konsumit të energjisë.

### Respektoni madhësitë e ngarkesës

Ngarkojeni lavatriçen deri në kapacitetin që tregohet në tabelën "SKEDA E PROGRAMEVE" për të kursyer ujë dhe energji.

### Zhurma dhe lagështia e mbetur

Këto ndikohen nga shpejtësia e rrotullimit: sa më e lartë të jetë shpejtësia e rrotullimit në fazën e rrotullimit, aq më e lartë është zhurma dhe lagështia e mbetur.

## PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA

*Për çdo seancë pastrimi dhe mirëmbajtjeje, fiken lavatriçen dhe hiqeni nga prizat. Mos përdorni lëngje të ndezshme për të pastruar lavatriçen.*

*Pastrojeni dhe mirëmbajeni herë pas here lavatriçen (të paktën 4 herë në vit).*

### Ndërprerja e furnizimit me ujë dhe me energji elektrike

Pas çdo larjeje, mbyllni rubinetin e ujit. Kjo do të kufizojë konsumimin e sistemit hidraulik brenda lavatriçes dhe do të ndihmojë në parandalimin e rrjedhjeve.

Hiqni lavatriçen nga prizat kur e pastroni ose gjatë gjithë punës së mirëmbajtjes.

### Pastrimi i lavatriçes

Pjesët e jashtme dhe komponentët prej gome të lavatriçes mund të pastrohen me një leckë të butë të njomur me ujë të vakët dhe sapun. Mos përdorni tretës ose lëndë gërryese.

### Pastrimi i ndarjes së detergjentit

Hiqni ndarjen duke e ngritur dhe duke e tërhequr për jashtë. Lajeni me ujë të rrjedhshëm. Kjo procedurë duhet të zbatohet shpesh.

### Kujdesi për derën dhe kazanin

Gjithmonë lëreni pak hapur derën e pajisjes për të parandaluar krijimin e aromave të pakëndshme.

### Pastrimi i pompës

Lavatriça është e pajisur me një pompë vetëpastrimi që nuk kërkon asnjë lloj mirëmbajtjeje. Artikujt e vegjël (si monedhat ose kopsat) ndonjëherë mund të bien në paradhomën mbrojtëse që gjendet në baza e pompës. Sigurohuni që cikli i larjes të ketë përfunduar dhe hiqeni pajisjen nga prizat. Për të aksesuar paradhomën:

- hiqni panelin mbulues në pjesën e përparme të lavatriçes, duke futur kaçavidën në qendër dhe në anët e panelit dhe duke e përdorur atë si levë;
- vendosni një kontejner të ulët dhe të gjerë nën filtrin e ujit, në mënyrë që të mblihdhni ujin e mbetur.
- lironi kapakun e pompës së shkarkimit duke e rrotulluar në drejtim të kundërt të akrepave të orës: është normale që të rrjedhë pak ujë;
- pastroni tërësisht pjesën e brendshme;
- vidhosni sërish kapakun;
- rivendosni panelin në vend duke u siguruar që grepat të vendosen në vendet e caktuara para se ta shtyni panelin në pajisje.

### Kontrollimi i zorrës së futjes së ujit

Kontrollojeni zorrën e futjes së ujit të paktën një herë në vit. Nëse është e plasarit ose e çarë, ajo duhet të zëvendësohet: gjatë cikleve të larjes, presioni i lartë i ujit mund ta çajë zorrën papritmas.

! Mos përdorni asnjëherë zorra që janë përdorur më parë.

## IZOLUESI ANTIMIKROBIK

Izoluesi rreth derës së lavatriçes është i përbërë nga një përzierje e veçantë që siguron mbrojtje antimikrobike, duke zvogëluar kështu krijimin e baktereve me 99,99%.

Izoluesi përmban piriton zinku, një substancë biocide që zvogëlon krijimin e mikrobeve të dëmshme (\*), si p.sh. ndotës dhe myk që shkaktojnë njolla, aroma të pakëndshme dhe dëmim të produktit.

(\*) **Bazuar në testet e kryera nga Universiteti i Perugia-s në Itali, mbi:**

Stafilococcus aureus, E. coli, Pseudomonas aeruginosa, Candida albicans, Aspergillus niger, Penicillium digitatum

Në raste të rralla, mund të shkaktohen reaksione alergjike nga kontakti i lëkurës me izoluesin.

## AKSESORËT

*Kontaktoni me shërbimin tonë të asistencës teknike për të kontrolluar nëse aksesoret e mëposhtëm disponohen për këtë model të lavatriçes.*

### Kompleti i stivimit

Me këtë aksesor mund të siguroni tharësen e rrobave në pjesën e sipërme të lavatriçes, për të kursyer hapësirë dhe për të lehtësuar ngarkimin dhe shkarkimin e tharësës së rrobave.






## TRANSPORTI DHE MENAXHIMI


*Mos e ngrini lavatriçen duke e kapur nga pjesa e sipërme.*

Hiqeni pajisjen nga prizat dhe mbyllni rubinetin e ujit. Kontrolloni nëse dera dhe sirtari i ndarjes së detergjentit janë mbyllur mirë. Shkëputni zorrën mbushëse nga rubineti i ujit dhe më pas shkëputni zorrën e shkarkimit. Boshatisni të gjithë ujin e mbetur te zorrë dhe sigurojini këto të fundit në mënyrë që të mos dëmtohen gjatë transportit. Vendosni sërish bulonat e transportit. Përsëritni në rend të kundërt procedurën e heqjes së bulonave të transportit të përkthuar në "Udhëzimet e instalimit".

## ZGJIDHJA E PROBLEMEVE


Ndonjëherë lavatriçja mund të mos funksionojë. Para se të kontaktoni me shërbimin e asistencës teknike, sigurohuni që problemi nuk mund të zgjidhet lehtësisht duke përdorur listën në vijim.

Anomalitë	Shkaqet/zgjidhja e mundshme
<b>Lavatriçja nuk ndizet.</b>	Pajisja nuk është futur si duhet në prizë, ose nuk është futur mjaftueshëm për të bërë kontakt. Nuk ka energji elektrike në shtëpi.
<b>Cikli i larjes nuk fillon.</b>	Dera e lavatriçes nuk është mbyllur siç duhet. Butoni "NDEZJA/FIKJA"  nuk është shtypur. Butoni "NISJA/VENDOSJA NË PAUZË"  nuk është shtypur. Nuk është hapur rubineti i ujit. Është caktuar një vonesë për kohën e nisjes. Modaliteti i demonstrimit është aktiv (shikoni më poshtë për ta çaktivizuar).
<b>Lavatriçja nuk mbushet me ujë (në ekran shfaqet mesazhi "E").</b>	Zorra e hyrjes së ujit nuk është e lidhur me rubinetin. Zorra është e përthyer. Nuk është hapur rubineti i ujit. Nuk ka furnizim me ujë në shtëpi. Presioni është shumë i ulët. Butoni "NISJA/VENDOSJA NË PAUZË"  nuk është shtypur.
<b>Lavatriçja ngarkon dhe shkarkon ujë vazhdimisht.</b>	Zorra e shkarkimit nuk është vendosur brenda diapazonit 65 deri në 100 cm nga dyshemeja. Ana e lirë e zorrës është e zhytur në ujë. Sistemi i shkarkimit në mur nuk është i pajisur me një tub ajrosjeje. Nëse problemi vazhdon edhe pas këtyre kontrolleve, mbyllni rubinetin e ujit, fikni pajisjen dhe kontaktoni me shërbimin e asistencës teknike. Nëse shtëpia është në një nga katet e sipërme të një ndërtese, mund të ketë probleme me tubin e rrjedhës së kundërt të sifonit, që mund t'i shkaktojë mbushjen me ujë dhe shkarkimin e vazhdueshëm të lavatriçes. Valvulat speciale anti-sifon disponohen në dyqane dhe ndihmojnë për parandalimin e këtij problemi.
<b>Lavatriçja nuk kryen procesin e shtrydhjes dhe në ekran është simboli  (F9E1).</b>	Pastrimi i filtrit të pompës (shikoni kapitullin "Kujdesi dhe mirëmbajtja") Zorra e shkarkimit është e përthyer. Kanali i shkarkimit është i bllokuar.
<b>Lavatriçja dridhet shumë gjatë ciklit të rrotullimit.</b>	Bulonat e transportit nuk janë hequr siç duhet gjatë instalimit. Lavatriçja nuk është e niveluar. Lavatriçja është vendosur midis dollapëve dhe murit.
<b>Lavatriçja rrjedh.</b>	Zorra e hyrjes së ujit nuk është vidhosur siç duhet. Sirtari i ndarjes së detergjentit është bllokuar. Zorra e shkarkimit nuk është montuar siç duhet.
<b>Simboli  pulson dhe ekran shfaq një kod gabimi (p.sh.: F1E1, F4...).</b>	Fikeni dhe hiqeni nga priza lavatriçen, prisni rreth 1 minutë dhe ndizeni sërish. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni me shërbimin e asistencës teknike.
<b>Ka shumë shkumë.</b>	Detergjenti nuk është i përshtatshëm për lavatriçe (duhet të mbajë shënimin "për lavatriçe" ose "për larje me dorë dhe me lavatriçe" ose një shënim të ngjashëm). Është përdorur shumë detergjent.
<b>Ikona e fazës  pulson, shfaqet shpejtësia e rrotullimit "0".</b>	Disbalanca e ngarkesës së rrobave ndaloi ciklin e rrotullimit, për të mbrojtur lavatriçen. Nëse dëshironi të rrotulloni rrobat e lagura, shtoni më shumë artikuj rrobash të ndryshme dhe nisni programin "Rrotullim dhe shkarkim". Shmangni ngarkesat e vogla të veshjeve, me disa rroba të mëdha dhe përthithëse / lani artikuj me përmasa të ndryshme në një larje.

**Çaktivizimi i MODALITETIT TË DEMONSTRIMIT:** Veprimet e mëposhtme duhet të kryhen pa ndërprerje. Ndizni lavatriçen dhe më pas fikeni sërish. Shtypni butonin "NISJA/VENDOSJA NË PAUZË"  derisa të ndihet një dridhje. Ndizeni sërish lavatriçen. Treguesi "DEMONSTRIMI" pulson dhe më pas fiket.

### Dokumentacioni i rregullorëve, dokumentacioni standard dhe informacione të tjera që kanë të bëjnë me porositjen e pjesëve rezervë dhe me produktin mund të gjenden:

- Duke skanuar kodin QR të pajisjes
  - Duke vizituar faqen tonë të internetit [docs.hotpoint.eu](https://docs.hotpoint.eu) and [parts-selfservice.europeanappliances.com](https://parts-selfservice.europeanappliances.com)
  - Përndryshe, kontaktoni shërbimin tonë të mbështetjes pas shitjes (shihni numrin e telefonit në dokumentin e garancisë). Kur kontaktoni shërbimin tonë të mbështetjes pas shitjes, jepni kodet e dhëna në pllakën e identifikimit të produktit tuaj.
  - Për informacionet e përdoruesit në lidhje me riparimin dhe mirëmbajtjen, vizitoni faqen [www.hotpoint.eu](https://www.hotpoint.eu)
- Mund të gjeni më shumë informacion në lidhje me modelin tuaj në internet në <https://eprel.ec.europa.eu/> që është baza zyrtare e të dhënave e produkteve EPREL të BE-së. Pasi të zgjidhni kategorinë e produktit, futni identifikuesin e modelit të produktit. Identifikuesi i Modelit përbëhet nga shkronja dhe numra dhe mund të gjendet në pllakën e identifikimit, si Mod. (shih imazhin në të djathtë).





# PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA

Për çdo seancë pastrimi dhe mirëmbajtjeje, fikeni lavatriçen dhe hiqeni nga priza.  
Mos përdorni lëngje të ndezshme për të pastruar lavatriçen.

## PASTRIMI I PJESËS SË JASHTME TË LAVATRIÇES


Përdorni një leckë të butë të lagur për të pastruar pjesët e jashtme të pajisjes.

Mos përdorni pastrues për xhamat ose përdorim të përgjithshëm, pluhur gërryes ose produkte të ngjashme për të pastruar panelin e kontrollit - këto substanca mund të dëmtojnë printimet.

## KONTROLLI I ZORRËS SË FURNIZIMIT ME UJË


Kontrolloni zorrën e hyrjes rregullisht për plasaritje dhe çarje. Nëse është dëmtuar, zëvendësojeni me një zorrë të re që mund ta merrni përmes shërbimit të mbështetjes pas shitjes ose shitësit specialist.

Në varësi të llojit të zorrës:



Nëse zorra e hyrjes ka një veshje transparente, kontrolloni në mënyrë periodike nëse ngjyra intensifikohet në zona lokale.


Nëse po, zorra mund të ketë rrjedhje dhe duhet të zëvendësohet.




Për zorrët e ujit me valvulë mbyllëse: kontrolloni dritaren e inspektimit të valvulës së vogël të sigurisë (shikoni shigjetën). Nëse është e kuqe, është aktivizuar funksioni i ndalimit të ujit dhe zorra duhet të zëvendësohet me një të re. Për të zhvidhosur këtë zorrë, shtypni butonin e nxjerrjes (nëse disponohet) ndërsa zhvidhosni zorrën.

## PASTRIMI I FILTRAVE RRJETË NË ZORRËN E FURNIZIMIT ME UJË


1. Mbyllni rubinetin e ujit dhe zhvidhosni zorrën e hyrjes.




2. Pastroni me kujdes me anë të një furçe filtrin rrjetë në fund të zorrës.



3. Tani zhvidhosni manualisht zorrën e hyrjes në pjesën e pasme të lavatriçes. Nxirrni filtrin rrjetë nga valvula në pjesën e pasme të lavatriçes duke përdorur pincat dhe pastrojeni me kujdes.



4. Futeni sërish filtrin rrjetë. Lidhni sërish zorrën e hyrjes me rubinetin e ujit dhe lavatriçen. Mos përdorni vegla për të lidhur zorrën e hyrjes. Hapni rubinetin e ujit dhe kontrolloni nëse lidhjet janë të shtrënguara.





## PASTRIMI I NDARJES SË DETERGJENTIT

Hiqni ndarjen duke e ngritur dhe duke e tërhequr për jashtë (shikoni figurën).


Lajeni nën ujë të rrjedhshëm; ky veprim duhet të përsëritet shpesh.




## PASTRIMI I FILTRIT TË UJIT/SHKARKIMI I UJIT TË MBETUR

**Fikeni dhe hiqni nga prizat lavatriçen para se të pastroni filtrin e ujit ose të zbrazni ujin e mbetur. Nëse keni përdorur një program me ujë të ngrohtë, prisni derisa uji të ftohet para se ta zbrazni. Pastrojeni filtrin rregullisht çdo 3 muaj, për të parandaluar moszbrazjen e ujit pas larjes për shkak të bllokimit të filtrit. Nëse uji nuk mund të zbrazet, ekrani tregon që filtri i ujit mund të jetë bllokuar.**


1. Hiqni panelin e bazamentit: Veproni siç tregohet në figurën e mëposhtme duke përdorur një kaçavidë.




2. Kontejneri për ujin e zbrazur: Vendosni një kontejner të ulët dhe të gjerë nën filtrin e ujit, në mënyrë që të mbledhni ujin e mbetur.




3. Zbrazni ujin: Rrotullojeni ngadalë filtrin në drejtim të kundërt të akrepave të orës derisa të ketë dalë i gjithë uji. Lejoni rrjedhjen e ujit pa e hequr filtrin. Pasi kontejneri të mbushet, mbylleni filtrin e ujit duke e rrotulluar në drejtim të akrepave të orës. Boshatisni kontejnerin. Përsëriteni veprimin derisa të jetë zbrazur i gjithë uji.




4. Hiqni filtrin: Shtroni një rrobë pambuku poshtë filtrit të ujit, e cila mund të thithë një sasi të vogël të ujit të mbetur. Më pas hiqni filtrin e ujit duke e rrotulluar në drejtim të kundërt të akrepave të orës.



5. Pastroni filtrin e ujit: hiqni mbetjet në filtër dhe pastrojeni atë nën ujë të rrjedhshëm.



6. Futni filtrin e ujit dhe instaloni sërish kapakun e poshtëm: Futni sërish filtrin e ujit duke e rrotulluar në drejtim të akrepave të orës. Sigurohuni që ta rrotulloni deri aq sa të jetë e mundur; doreza e filtrit duhet të jetë në pozicion vertikal. Për të testuar shtrëngimin e filtrit të ujit, mund të hidhni rreth 1 litër ujë në ndarjen e detergjentit. Më pas, instaloni sërish kapakun e poshtëm.



# TRANSPORTI DHE MENAXHIMI

**Mos e ngrini asnjëherë pajisjen duke e mbajtur nga pjesa e sipërme.**

1. Nxirrni spinën elektrike dhe mbyllni rubinetin e ujit.
2. Sigurohuni që dera dhe ndarja e detergjentit të jenë mbyllur siç duhet.
3. Shkëputni zorrën e hyrjes nga rubineti i ujit dhe hiqni zorrën e shkarkimit nga pika juaj e shkarkimit. Hiqni të gjithë ujin e mbetur nga zorrët dhe rregullojini ato në mënyrë që të mos dëmtohen gjatë transportit.

4. Rivendosni bulonat e transportit. Ndiqni në rend të kundërt udhëzimet për heqjen e bulonave të transportit të dhëna tek "Udhëzuesi i instalimit".

**E rëndësishme:** Mos e transportoni lavatriçen pa fiksuar bulonat e transportit.

## SHËRBIMI I MBËSHTETJES PAS SHITJES

### PARA SE TË TELEFONONI SHËRBIMIN E MBËSHTETJES PAS SHITJES

1. Shikoni nëse mund ta zgjidhni vet problemin me ndihmën e sugjerimeve të dhëna te seksioni **ZGJIDHJA E PROBLEMEVE**


2. Fikni dhe rindizni pajisjen për të parë nëse problemi vazhdon.

### NËSE PROBLEMI VAZHDON EDHE PAS KONTROLLEVE TË MËSIPËRME, KONTAKTONI SHËRBIMIN MË TË AFËRT TË MBËSHTETJES PAS SHITJES

Telefononi numrin e treguar në dokumentin e garancisë për të marrë ndihmë.

Kur kontaktoni shërbimin tonë të mbështetjes së klientit pas shitjes, specifikoni gjithmonë:

- një përshkrim të shkurtër të problemit;
- llojin dhe modelin e saktë të pajisjes;



- numrin e shërbimit (numrin pas fjalës "Service" në pllakën e specifikimeve).

**SERVICE** 0000 000 00000



- adresën tuaj të plotë;
- numrin tuaj të telefonit.

Nëse kërkohen riparime, kontaktoni një shërbim të autorizuar të mbështetjes pas shitjes (për të garantuar që do të përdoren pjesë këmbimi origjinale dhe që riparimet do të kryhen saktë).